

V E N D I M
Nr.473, datë 29.7.1998

**PËR RREGULLAT KRYESORE TË VEPRIMTARISË SË AGJENCIVE TË
TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE DHE TË TRANSPORTUESVE QË KRYEJNË
TRANSPORTIN ME AUTOBUS**

Në zbatim të nenit 21 dhe 24 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Transporti i udhëtarëve dhe i bagazheve të tyre kryhet nëpërmjet agjencive të transportit të udhëtarëve, që kanë lidhur kontratë me shoqëritë e transportit, sipas kërkesave të Kodit Civil për këtë shërbim ose si pjesë e veprimtarisë së tyre.

Agjencitë e transportit të udhëtarëve detyrohen:

1.1 Të marrin përsipër dhe të ndihmojnë udhëtarët për t'u mundësuar udhëtimin në linjat dhe në oraret, sipas kontratës së lidhur nga këto agjenci me shoqëritë e transportit. Përfaqësuesi i saj është i pranishëm në nisjen dhe në mbërritjen e autobusëve dhe mban shënim parregullsitë që mund të ndodhin gjatë udhëtimit, si dhe ankesat e udhëtarëve, për të vënë në dijeni transportuesin dhe organet e transportit.

1.2 Të afishojnë dukshëm në vendqëndrimet e autobusëve, vendin e nisjes dhe të mbërritjes së autobusit, si dhe vendndalimet gjatë udhëtimit, me oraret përkatëse në nisje dhe në mbërritje, oraret e transportit të kombinuar, si dhe kushtet për transportimin e bagazheve.

1.3 Të shesin dhe të rezervojnë biletat e udhëtarëve, me çmim jo më të lartë se tarifa maksimale e miratuar për linjën përkatëse, si dhe biletat e bagazheve. Në biletë të shënojnë numrin e autobusit, numrin e vendit të uljes së udhëtarit në autobus, vendnisjen dhe vendmbërritjen, orën dhe datën e nisjes. Bileta të jetë e vulosur me emërtimin e transportuesit. Për kryerjen e një transporti kolektiv të përdoret fatura për shërbimin e kryer ose një dokument tjetër i njësuar me të.

1.4 Në rastet e transportimit të bagazheve të udhëtarëve, si në rastin e biletës së udhëtimit, duhet të shënohen në biletën përkatëse numri i autobusit, si dhe të dhënat e tjera. Kjo biletë përbëhet nga dy pjesë, njëra i bashkëngjitet biletës së udhëtimit, tjetra i bashkëngjitet bagazhit që udhëtari dorëzon në autobus para nisjes.

1.5 T'u japin përparësi në transport të gjithë personave që, sipas ligjit, përfitojnë lehtësi transporti.

1.6 Të bëjnë shënimet përkatëse në fletudhëtimin tip, të miratuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, e plotësuar rregullisht nga transportuesit për pjesën që i takon para nisjes.

1.7 Të japin leje për nisjen e autobusit vetëm atëherë kur transportuesi të ketë plotësuar kushtet dhe rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

1.8 Të mbajnë në mënyrë të rregullt ditore dhe periodike, të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tyre dhe të transportuesit, të cilit i shërben, si dhe të ardhurat nga shitja e biletave dhe nga biletat e bagazheve, vëllimin e punës së realizuar gjatë transportimit të udhëtarëve, rregullsinë e funksionimit të linjës si kohën e nisjes, të

mbërritjes etj. dhe t'i ruajnë ato për 5 vjet. Këto të dhëna u njoftohen në mënyrë të rregullt transportuesit të cilit i shërben, si dhe organeve të

transportit kur ato i kërkojnë.

1.9 T'u krijojnë organeve të transportit të gjitha kushtet e nevojshme për kontroll ose për dhënien e informacioneve të ndryshme.

1.10 Organi që ka të drejtën e dhënies së lejes për agjencitë a shoqëritë e transportit turistik, e jep atë vetëm kur autobusët e tyre të jenë të pajisur me aktet e vlerësimit teknik, në përputhje me udhëzimet e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

1.11 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit miraton formatin e biletës së udhëtimit dhe të bagazhit. Shtypja e biletave të udhëtimit dhe atyre të bagazhit të bëhet në mënyrë të përcaktuar nga organi i autorizuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

1.12 Për të kryer sa më mirë veprimtaritë e tyre, si dhe për të qenë sa më afër kërkesave dhe nevojave të udhëtarëve, agjencitë marrin masa për pajisjen e tyre me ndërlidhje telefonike, sipas kushteve që mundësojnë operatorët përkatës në fushën e telekomunikacionit.

2. Shoqëritë e transportit të udhëtarëve detyrohen:

2.1 Ta zhvillojnë veprimtarinë e tyre brenda afateve kohore të përcaktuara për vlefshmërinë e licencës për këtë veprimtari.

2.2 Të mbajnë në çdo autobus që përdorin në linjë certifikatën, e cila provon pasjen e licencës dhe gatishmërinë e mjetit për të kryer transportin.

2.3 Të punësojnë drejtues të mjeteve të transportit në përputhje me kërkesat ligjore.

2.4 Të përdorin për udhëtim autobusë, të cilët kanë kryer kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik, si dhe shërbimet korente para nisjes në udhëtim dhe testimin e veçantë për plotësimin e kushteve të komoditetit sipas udhëzimeve të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

2.5 Të shënojnë në çdo autobus që përdoret për transportin e udhëtarëve, numrin e tij, vendin e nisjes dhe të mbërritjes, si dhe kohën e nisjes dhe të mbërritjes.

2.6 Të sigurojnë kushte të përshtatshme për udhëtarët gjatë udhëtimit dhe vende të përshtatshme për bagazhet e tyre.

2.7 Të sigurojnë autobus tjetër në rast të ndërprerjes së udhëtimit për difekte teknike deri në vendin e mbërritjes, kundrejt biletës fillestare të udhëtarit. Në rast ndërprerjeje të udhëtimit për forca madhore, të marrin masa për kthimin e udhëtarëve, pa pagesë, në vendin nga ku janë nisur, duke u kthyer atyre edhe vlerën e plotë të biletës përkatëse, pas paraqitjes së tyre.

2.8 Të ndalojnë transportin e bagazheve, që përmbajnë lëndë djegëse, plasëse, gërryese dhe në përgjithësi, mallra që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e udhëtarëve.

2.9 Të pajisin drejtuesit e autobusit me fletudhëtim dhe të fillojnë udhëtimin vetëm pasi ajo të jetë plotësuar nga personeli i agjencisë së transportit të udhëtarëve, me të cilën shoqëritë e transportit kanë lidhur kontratë për shërbimet e transportit ose nga një punonjës i tyre i ngarkuar me shërbimin e agentit.

2.10 Të mbajnë në mënyrë të rregullt të gjitha evidencat që pasqyrojnë veprimtarinë e tyre transportuese, duke iu nënshtruar të gjitha sistemeve të evidencave

që kërkohen nga organet e transportit dhe t'i ruajnë ato edhe 5 vjet pas përfundimit të transportit.

2.11 Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit që, nëpërmjet organeve të saj vartëse, të sigurojë dhe të shpërndajë fletudhëtimet dhe biletat e udhëtarëve dhe të bagazheve, sipas kërkesave të transportuesve. Të gjitha aktet nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano